



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 14 Shkurt 2022

Nr. 17

V E N D I M

P Ë R

**PËRDORIMIN E KAMERAVE REGJISTRUESE DHE TË MONITORËVE PËR SHFAQJEN
E FLETËVE TË VOTIMIT NË VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE,
NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, pika 2, shkronja “c”, nenit 22, pika 2, nenit 23, pika 1, nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

V E N D O S I:

1. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve), për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në Vendin e Numërimit të Votave, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.
2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga Vendet e Numërimit të Votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.
3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve), dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga Vendet e Numërimit të Votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ nga Komisioni Rregullator.
4. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga Vendet e Numërimit të Votave, në ambientet e Komisionit Qendror të



Data: 14 Shkurt 2022

Nr. 17

“Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendet e Numërimit të Votave në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

Zgjedhjeve, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, kryhet nga operatorë të kontraktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar